

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79650
Më 4.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejitimin e mjeteve për mbështetje financiare për Auto klubin "Drini", kryetari i Komunës më 4 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Auto klub "Drini" nga Prizreni, për mbështetje financiare për organizimin e garës automobilistike, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 500 €.

Ky aktivitet do të mbahet në Prizren dhe pritet të marrin pjesë klube automobilistike nga shtetet fqinje.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, Auto klub "Drini", si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja